



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E SHENDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
DREJTORIA E SPITALIT RAJONAL GJIROKASTER

Nr. _____prot.

Gjirokaster, më 30.06.2023

PROCESVERBAL

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Mirembajtja e pajisjeve të mëdha mjekësore “full risk”, Marreveshje kuader me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara- me afat 2 vjeçar (24 muaj)”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Kodi – Shërbime mirëmbajtjeje -98341110-9

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor *Drejtoria e Spitalit Rajonal Gjirokaster* ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kriteret e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas Kriterëve të përgjithshme të kualifikimit.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të deklaratave të xhiros vjetore për tre vitet e fundit (2020-2021-2022). Vlera mesatare e xhiros së këtyre tre viteve duhet të jetë në masën 40% të fondit limit/vlerës së pritshme të kontratave për te cilat oferton

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës sëkërkuar ngaautoriteti/entikontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Bazuar në nenin 43 pika 2/a, 43 pika 3 dhe 43 pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet:

Neni 43 pika 2/b

Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;

Neni 43 pika 3

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Neni 43 pika 5

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale, llogaritet mbi bazën e vlerës maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër. Gjithashtu lidhur me përcaktimin e viteve të kërkuara për paraqitjen e dokumentacionit lidhur me xhiron vjetore, sqarojmë se afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave të kësaj procedure prokurimi përkon me mesin e muajit Korrik 2023, rrjedhimisht për këtë arsye operatorët ekonomik kanë kohë të mjaftueshme për paraqitjen e një kopje të deklaratës së xhiros vjetore të realizuar edhe për vitin 2022.”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 29, te Ligjit Nr. 8438, dt. 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar, ku përcaktohet: *Çdo tatimpagues pergatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës,*

Kjo është një kërkesë e cila nuk e pengon konkurrencën dhe është e bazuar në garancinë që ofertuesi i paraqet Autoritetit Kontraktor për besueshmerinë dhe qendrueshmerinë e tij.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate/vlerës së pritshme të kontratave.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të madhe se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori duhet të ketë pjesë të stafit të tij të paktën një inxhinier për mirëmbajtjen e aparaturës objekt të këtij prokurimi me profil inxhinier biomjekesor/elektronik.

Per këtë OE duhet të disponojë dokumentat e mëposhtme provuese për secilin nga stafi më sipër;

-CV-ne e specialistit/ve

-Certifikata /dëshmitë e trajnimit për pajisjen objekt prokurimi, leshur nga kompania prodhuese

-Kontrate pune/shërbimi e vlefshme

-Listepagesa ku të figurojnë emrat e inxhinierve të deklaruar që nga periudha Shkurt 2023

Argumentimi : Bazuar në pikën 4, të nenit 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikave 4/b dhe 4/c të nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale.

Nisur nga volumi punës si dhe eksperiencat e mëparshme 1 inxhinier është mëse i mjaftueshëm për ofrimin e shërbimit objekt prokurim.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën një inxhinier për mirëmbajtjen e sistemit operativ windows në nivel MCSE ose ekuivalent të aparaturës objekt të këtij prokurimi me profil inxhinier biomjekësor/elektronik/

Per këtë OE duhet të disponojë dokumentat e mëposhtme provuese për secilin nga stafi me sipër;

-CV-ne e specialistit/ve

- Certifikata /deshmite e trajnimit për pajisjen objekt prokurimi, leshur nga kompania prodhuese

- Kontrate pune/shërbimi e vlefshme

-Listepagesa ku të figurojnë emrat e inxhinierve të deklaruar që nga periudha Shkurt 2023

Argumentimi : Bazuar në pikën 4, të nenit 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikave 4/b dhe 4/c të nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale.

Nisur nga volumi punës , 1 inxhinier është mëse i mjaftueshëm për mirëmbajtjen e sistemit operativ windows në nivel MCSE ose ekuivalent të aparaturës objekt të këtij prokurimi.

2.3.4 Një deklaratë që merr përsipër kryerjen e mirëmbajtjes së tipit FULL RISK sipas rekomandimit të prodhuesit dhe specifikimeve teknike.

Argumentimi : Bazuar në nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 2 të nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku ndër të tjera përcaktohet se këto kërkesa i shërbejnë autoritetit kontraktor për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale.

2.3.5 Një deklaratë që merr përsipër zëvendësimin e pjesëve të këmbimit dhe konsumit, që ato do jenë të reja dhe origjinale dhe në përputhje me ato të përdorura fillimisht (të garantuara nepermjet certifikimit CE ose FDA) dhe që përfshihen në vlerën e kontratës dhe se garancia e pjesëve të këmbimit do të jetë për një periudhë jo më pak se një vit nga momenti i lëvrimit.

Argumentimi : Bazuar në nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 2 të nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku ndër të tjera përcaktohet se këto kërkesa i shërbejnë autoritetit kontraktor për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale. Në mbështetje të Nenit 17 të Ligjit nr.89/2014 “Për pajisjet mjekësore” si dhe të nenit 7 të ligjit 21/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 89/2014”, krahas kërkesës së miratimit/certifikimit CE, AK lejon edhe mundësinë e paraqitjes së certifikatës FDA, si një dokument, i cili konfirmon konformitetin e pajisjeve/artikujve mjekësorë objekt prokurimi, me qëllim hartimin e kriterit në konformitet me dispozitat në fuqi, si dhe moskufizimin e OE, të cilët tregtojnë dhe paraqesin pajisje dhe artikuj mjekësorë vetëm me certifikimin FDA dhe jo me certifikimin CE.

2.3.6 Ofertuesi duhet të jetë i certifikuar ISO 13485:2016 ”Për sistemin e menaxhimit të cilësive për pajisjet mjekësore /ose/ ekuivalent. Për këtë ai duhet të paraqesë certifikatën përkatëse, të vlefshme. Certifikata të jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga

organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi : Ky kriter vihet në përputhje me pikën 1 të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” lidhur me kualifikimin profesional dhe aftësinë teknike dhe me pikën 3 të nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Ky kriter është i lidhur ngushte me objektin e kësaj kontrate si dhe me aftësinë zbatuese të kontratës, me garantimin e kapaciteteve profesionale nga OE pjesëmarrës si dhe rekomandimit të APP nr. 7998 datë 24.12.2021 “Mbi hartimin e kriterëve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, punë, shërbime.

2.3.7 Një deklaratë që pranon oraret e kryerjes së shërbimeve dhe shpejtësinë e ndërhyrjeve.

Argumentimi : Bazuar në nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 2 të nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku ndër të tjera përcaktohet se keto kërkesa i shërbejnë autoritetit kontraktor për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale.

2.3.8 Planin e veprimeve të mirëmbajtjes parandaluese që ofertuesi do të ndërmarrë, për pajisjen , ku të përcaktohen periodiciteti, procedurat operative dhe protokollat që do të përdorë përfshirë kalibrimet dhe testimet periodike të sigurisë elektrike dhe mekanike të pajisjeve në përputhje me standartet përkatëse evropiane.

Argumentimi : Bazuar në nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 2 të nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku ndër të tjera përcaktohet se keto kërkesa i shërbejnë autoritetit kontraktor për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale.

Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike¹. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin*

Specifikimet teknike

1	2	4	5	6	7
Nr	Përshkrimi	Njesia	Sasia	Destinacioni	Afati i ekzekutimit
1	Mirëmbajtje Full Risk e pajisjes Skaner Spitali Gjirokastrë Toshiba/TSX-021B/4	Muaj	24	SRGJ	24 muaj

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”